

# Mënyrat e dhënies së informacionit

1. Të gjitha kërkesat për informacion trajtohen, si irregull, nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjeshterit e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar e-albania.al apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik në internet.
2. Kërkesat, që lidhen me dokumente të shkruara, trajtohen duke vënë në dispozicion të kërkuesit:
  - a. një kopje të plotë, në format të njëjtë me atë të përdorur nga autoriteti publik, përvèç rasteve të veçanta;
  - b. një kopje të plotë të informacionit nëpërmjet postës elektronike, kur informacioni gjendet në një formë të tillë ose mund të konvertohet.
3. Lidhur me kërkesat që lidhen me forma të tjera, informacioni jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik.
4. Në çdo rast, vendimi i refuzimit për formën e kërkuar jepet me shkrim dhe i arsyetuar.